

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Gani Avdiu, kryeses dhe Rafet Haxhaj e Isa Shala -anëtar (me tej kolegji), në kontestin e paditësit S.H., nga Juniku, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Sh. a. në Prishtinë (më tej PTK), e përfaqësuar nga Hajredin Islami, për pagesën e diferencës në pagë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1503/2012 të datës 26.08.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.10.2016 jep:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa themeltë ankesa e të paditurës PTK, dhe **Vërtetohet** paragrafi I. i dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1503/2012 të datës 26.08.2014, që ka të bëjë me anulimin e aktvendimit të paditurës PTK, nr.01-1040-921/12 i dt. 07.03.2012.

Prishet paragrafi i dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, C.nr.1503/2012 të datës 26.08.2014, me të cilin është detyruar e paditura që paditësit t'i paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 11 dhe 10, duke filluar nga data 01.02.2012 e deri në 31.08.2012, sipas kontratës së punës, me kamatë vonesë prej 4%, duke filluar nga data 01.02.2012 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, dhe çështja në këtë pjesë i kthehet gjykatës së shkallës së parë në **rigjykim**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin C.nr.1503/2012 të datës 26.08.2014, ka vendosur si vijon:

“Aprovohet në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.H. nga Juniku, Anulohet aktvendimi i të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës nr.01-1040-921/12 i datës 07.03.2012, Detyrohet e paditura që paditësit ti paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes gradës 11 dhe 10 duke filluar nga data 01.02.2012 e deri me dt. 31.08.2012 sipas kontratës së punës, me kamatë vonesë prej 4% në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. II. Obligohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën e parave prej 30 euro.”

Përfaqësuesi i të paditurës më dt. 03.09.2014, ka paraqitur ankesë, kundër aktgjykimit të shkallës së parë me të cilën ka kërkuar që aktgjykimi ankimor të ndryshohet, ashtu që të

refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S.H., ose i njëjti të prishet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim, duke parashtruar këto shkaqe: *Shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Kompetenca: Gjykata e Apelit, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare vlerësoi se ka juridiksion për procedim dhe vendimmarrje në këtë çështje juridike, duke u bazuar në nenet 17.1, 18.1 e 19.1 të Ligjit për Gjykatat, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 79/2010).

Shqyrtimi i pranueshmërisë së ankesës: Kolegji, para shqyrtimit për meritat e ankesës paraprakisht duhet të shqyrtoi se ankesa a është e pranueshme në raport me dispozitat ligjore në këtë rast të neneve 176, 178 dhe 186 të LPK.

Në bazë të shkresave të lëndës (fletë dorëzimin për dorëzimin e kopjes së aktgjykimit ankimor palës ankuese si dhe shenjës së vulës së pranimit të dhënë nga gjykata kompetente në kopjen e ankesës), rezulton se: Ankesa është paraqitur në afat ligjor, pra i përmbush kërkesat e nenit 176 të LPK, ajo është e lejueshme sepse është paraqitur nga personi i autorizuar për paraqitjen e saj, ajo nuk është tërhequr dhe nuk ka hequr dorë më parë pala ankuese, për ankesën e paraqitur pala ankuese ka interes juridik.

Ankesa është e plotë sepse i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 178 të LPK.

Pra kolegji vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe i përmbushë kërkesat për të vendosur për themelësinë e saj.

Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë: Gjykata e Apelit, në bazë të nenit 194 të LPK, e ekzaminoi aktgjykimin e shkallës së parë dhe gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë në raport me par. I. të dispozitivit të aktgjykimit ankimor ndërsa sa i përket par. II. të aktgjykimit të shkallës së parë ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paragrafi I. i dispozitivit të aktgjykimit ankimor me të cilin është anuluar aktvendimi i të paditurës PTK, nr.01-1040-921/12 i dt. 07.03.2012, nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 b) g) j) k) dhe m) për të cilat gjykata e shkallës së dytë në procedurë sipas ankesës kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me shkelje të dispozitave të nenit 197 të LPK, si dhe drejtë dhe plotësisht është konstatuar gjendja faktike dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Gjykata e shkallës së parë kishte caktuar seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes dhe kishte marr provat e cekura në arsyetimin e aktgjykimit ankimor dhe kishte konstatuar gjendjen faktike të si vijon:

Se paditësi në cilësi të punëmarrësit dhe e paditura në cilësi të punëdhënësit më dt. 20.10.2011, kishin lidhur kontratën e punës në kohë të pacaktuar sipas të cilës paditësi ishte përcaktuar në punët dhe detyrat e punës "Agjent i shitjes në terren".

Me nenit 5 të kontratës përkatëse ishte përcaktuar se të punësuarit i caktohet paga bazë për punë të cilën e kryen te punëdhënësi në lartësi të “gradës 6”.

E paditura me vendimin e saj nr.01-1040-921/12 dt. 07.03.2012 paditësit i cakton të ardhura personale mujore në lartësi të “gradës 11”, sipas strukturave të gradave, duke i ulë paditësit gradën nga 11 në 10, vendimi përkatës zbatohet nga data 01.02.2012.

E paditura, si punëdhënësi, vendimin e saj e konsideron pjesë përbërëse të kontratës së punës, nr.01-2880-2587/2011 të dt. 20.10.2011 të cilën e kishte lidhur me punëmarrësin (tani paditësin), duke e arsyetuar se vendimi i saj është si pasojë e shkresës së dt. 06.12.2012, të Ministrisë së Zhvillimit ekonomik, drejtuar kryetarit të Bordit të drejtorëve të paditurës, me të cilën ishte rekomanduar zvogëlimi i shpenzimeve për personelin e të paditurës në raport me të hyrat për vitin 2012 i cili duhet të jetë jo më shumë se 20%.

Në bazë të kësaj gjendje të çështjes gjykata e shkallës së parë kishte vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor me arsyetim se marrëdhënia e punës në mes të paditëses dhe të paditurës është themeluar me kontratë me ç’rast është përcaktuar edhe paga sipas “gradës 11”. Kontrata e tillë është shprehje e vullnetit të palëve dhe nuk mund të ndryshohet me vullnetin e njëanshëm, por me pëlqimin e të dy palëve kontraktuese. Pra, ka vlerësuar se kontrata ka përmbushur kërkesat ligjore të nenit 11.1.8 të Ligjit të Punës.

Pretendimet ankimore: Përfaqësuesi i të paditurës në ankesën e paraqitur ka pohuar se vendimi i menaxherit ekzekutiv me të cilin paditësit i është caktuar paga sipas gradës 10 është i drejtë dhe i bazuar në nenin 5 të kontratës së punës si dhe në nenin 57 të Ligjit të Punës. Ka pohuar se arsytimi i aktgjykimit ankimor është i pa qartë dhe është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2n) të LPK, sepse paditësit në këtë rast paga i është përcaktuar edhe në harmoni me vendimin e aksionarit Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e zhvillimit e që përfshin reduktimin e shpenzimeve për personelin e PTK, Sh. A. lidhur me planin e biznesit për vitin 2012. Më tej në ankesë ka pohuar se padia e paditësit është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor të caktuar me nenin 79 të LP.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë të shprehur në paragrafin I të dispozitivit të aktgjykimit ankimor, kolegji e vlerëson të ligjshëm dhe të drejtë, sepse me nenin 55 të Ligjit të Punës, nr.3/L-212 është përcaktuar: “I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit”.

Nga kjo dispozitë ligjore rezulton se paga e punëtorit përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me Ligjin e Punës, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit, ndërsa ndryshimi i pagës së punëtorit, nuk mund të bëhet me veprim të njëanshëm të punëdhënësit pa u përmbushë kushtet ligjore të specifikuar me nenin 55 par.1 të LP.

Punëdhënësi në këtë rast deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes në shkallë të parë e as në procedurë sipas ankesës, nuk dëshmoi se paditësit i është ndryshuar paga, duke respektuar kriteret e specifikuar me nenin 55 par.1 të LP, pra së ndryshimi i nenit 5 të kontratës së punës është shprehje e vullnetit të palëve kontraktuese (punëdhënësit dhe punëmarrësit), por këtë e paditura e ka bërë me vendim të njëanshëm pa procedurë ligjore.

Vendimi i tillë nuk mund të konsiderohet pjesë e kontratës sepse ai në këtë rast nuk është shprehje edhe e vullnetit të punëmarrësit. Sa i përket pretendimit ankimor se padia e paditësit kundër të paditurës është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 79 të LP, nuk qëndron sepse kjo dispozitë ligjore nuk i referohet kërkesave nga marrëdhënia e punës që kanë të bëjnë me para, por vetëm kërkesave statusore. Afati i parashkrimit të kërkesave nga marrëdhënia e punës që kanë të bëjnë me para, është afat materialo-juridik jo procedural dhe si i tillë është rregulluar me nenin 87 të LP. Pra, padia me kërkesa të tilla nuk është e afatizuar, por vetëm e drejta e tillë mund të parashkruhet, dhe për këtë gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare, por sipas prapësimit të palës së interesuar.

Sa i përket paragrafit II të dispozitivit të aktgjykimit ankimor ai është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.2 n), të LPK, sepse dispozitivi i tij është i paqartë ngase nuk është përcaktuar saktë shuma monetare të cilën e paditura duhet t'ia paguaj paditësit.

Pra, në këtë rast paragrafi II i aktgjykimit ankimor nuk do të përfaqësonte dokument të përshtatshëm për përmbarrim sepse ai nuk përmban elementet e specifikuar me nenin 27 të LPP. Gjykata e shkallës së parë në këtë rast, ka vepruar sipas kërkesëpadiës së paqartë dhe nuk ka hapur shqyrtim për të gjitha faktet relevante dhe vendimtare në këtë çështje kontestimore, me çka palës ankuese i ka pamundësuar paraqitjen e plotë të çështjes në gjyq pra që të deklarohet për të gjitha faktet dhe pretendimet e palës paditëse, e që aktgjykimin ankimor e bëjnë të jetë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 197 c) të LPK.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim për këtë pjesë të kërkesëpadiës duhet ta ftoj paditësin që ta rregulloj kërkesëpadinë, duke caktuar shumën e të hollave që pretendon se duhet t'ia paguaj e paditura dhe sipas barrës së të provuarit përfshirë edhe marrjen e mendimit të ekspertit kompetent financiar, të konstatoj drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike, duke përcaktuar saktë shumën e diferencës së pagës në mes të gradës 11 dhe 10, si dhe kërkesat tjera aksesore gjatë afatit kohor të specifikuar në kërkesëpadi, me ç'rast do të krijoheshin kushtet ligjore për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale parakushte këto për vendimmarrje të ligjshme dhe të drejtë në këtë çështje kontestimore.

Me sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë krijuar kushtet ligjore nga nenet 197 c) dhe 200 të LPK, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË
CA. nr.4774/2014 dt. 27.10.2016

Kryesuesi i kolegjit-Gjyqtari,
Gani Avdiu